



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI I SHQIPËRISË**  
**KRYETARI**

*Tiranë, më 11 tetor 2018.*

Të dashur pjestarë të familjes së shkrimtarit tonë të nderuar, Fatos Arapi,

Me trishtim të thellë mësova për ndarjen nga jeta të Fatosit, njeriut të dashur për ju dhe për të gjithë shqiptarët, kudo ku jetojnë.

Me ikjen e tij po fluturon drejt qiellit një shtërg tjetër nga të fundmit e letërsisë dhe kulturës shqipe të shekullit të njëzetë.

Fatos Arapi ishte një shkrimtar, poet, pedagog, studjues intelektual dhe patriot i shquar.

Ai shkroi dhe i kushtoi të gjithë talentin e vet atdheut dhe krijoi lirika magjepsëse për lirinë dhe njerëzit e lirë të këtij vendi.

Në të dy shekujt që shkroi, Ai përjetoj dhe u përcolli lexuesve jo alarme të sajua, por shqetësimet reale të botës dhe kohrave të shqiptarëve.

I qoftë i lehtë dheu i tokës, të së cilës i këndoi me të gjithë fuqinë e shpirtit, furinë e pasionit dhe talentit të tij të rrallë.

Sinqerisht i juaji,

Gramoz Ruçi